



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1300 Prot.

Tiranë, më 30/09/2022

V E N D I M

Nr. 184, Datë 30/09/2022

Mbështetur në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Mbështetur nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur të gjithë hapat administrativë, që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 21, datë 01.02.2022, e Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, ku pretendohet diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të "racës", të pakicës kombëtare rome, nga ana e opinionistit Arben Meçe, të ftuar në Emisionin "Spot LIGHT", të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, si dhe nga ana e Televizionit Vizion Plus.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri është shprehur me Vendimin nr. 100, datë 23.05.2022, nëpërmjet së cilit është vendosur, si vijon:

1. *"Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e z. Arben Meçe si pasojë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në Emisionin Spot LIGHT, të datës 21.01.2022, në televizionin Vizion Plus.*
2. *Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e Televizionit Vizion Plus, si pasojë e mosmbajtjes së një qëndrimi kritik ndaj gjuhës së urrejtjes së përdorur nga z. Arben Meçe në emisionin Spot LIGHT, për mosdistancimin në mënyrë publike nga përdorimi i saj, si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në titullin e emisionit Spot LIGHT, të publikuar në faqen www.youtube.com.*

3. Referuar pikave 1 dhe 2 të këtij Vendimi, z. Arben Meçe dhe Televizioni Vizion Plus të shprehën me deklarata publike (verbale apo të shkruara) me anë të së cilave të kërkojnë falje ndaj pakicës kombëtare rome.
4. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Vizion Plus të marrë masa të menjëherëshme për të ndryshuar titullin e emisionit Spot LIGHT, të datës 21.01.2022, si dhe eliminimin/mbulimin e frazës diskriminuese të përdorur nga z. Arben Meçe në përmbajtjen e këtij emisioni, të publikuar në faqen www.youtube.com, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijani mbi këtë vendim, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, z. Arben Meçe dhe Televizioni Vizion Plus, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Në kushtet kur, Komisioneri nuk dispononte asnjë adresë të z. Arben Meçe, mbështetur në nenin 162 "Njoftimi Publik", të Kodit të Procedurave Administrative¹, nëpërmjet Njoftimit Publik nr.856, datë 03.06.2022, publikoi Vendimin nr. 100, datë 23.05.2022, në faqen zyrtare të institucionit, si dhe aktet e sipërcituara i afishoi gjithashtu edhe në ambientet e jashtme të godinës, ku KMD ushtron aktivitetin e tij². Pavarësisht se afati ligjor 10-ditor nga data e publikimit dhe afishimit të akteve të sipërcituara, u tejkalua deri në 3 muaj, z. Meçe nuk pati asnjë reagim ndaj vendimit nr. 100, datë 23.05.2022, të KMD-së, për të kërkuar falje publike ndaj pakicës kombëtare rome, sikurse përcaktohej në pikën 3 të tij.

¹ Neni 162, i KPA parashikon shprehimisht se: "1. Njoftimi publik bëhet në këto raste: a) kur palët janë të panjohura; b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur; ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji. 2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijani nga ai/ajo, të cilit i drejtohet. 3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni. 4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh. 5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrativ."

² Kjo mënyrë njoftimi është ndjekur për njoftimin e z. Meçe edhe gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës nr. 21, datë 01.02.2022, të Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë;

Ndërkohë që, e kundërta ndodhi me subjektin tjetër ndaj së cilit drejtohej ankesa, i cili kërkoi falje publike gjatë emisionit Emisionin *Spot LIGHT*, të datës 30.05.2022, plotësoi rigorozisht masat e përcaktuara në vendimin e KMD-së, si dhe e njoftoi Komisionerin zyrtarisht lidhur me sa më sipër.

Pas kryerjes së Njoftimit Publik nr. 856, datë 03.06.2022, Komisioneri e konsideron të mirëqenë faktin se z. Meçe ka marrë dijëni mbi Vendimin nr. 100, datë 23.05.2022 dhe nuk ka dërguar informacion mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi.

Komisioneri konstaton se z. Arben Meçe, në cilësinë e analistit të ftuar 21.01.2022, në Emisionin "Spot LIGHT", të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, nuk e ka zbatuar Vendimin e tij nr. 100, datë 23.05.2022 dhe është në shkelje të pikës 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, ku parashikohet: "Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni".

PËR KËTË ARSYE:


Mbështetur në nenin 162 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në pikat 11, 12, 13, shkronja "a", të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Z. Arben Meçe të gjobitet në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi. PAGESA e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i Vendimit nr. ~~100~~, datë ~~23.05.2022~~, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijëni mbi sanksionin, sjell shfuqizimin e tij.
4. Ndjekjen e procedurave të parashikuara në nenin 162 të Kodit të Procedurave Administrative për njoftimin e z. Arben Meçe mbi këtë vendim.

5. Z. Arben Meçe të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij Vendimi.
6. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI



Robert GAJDA

